

Analiza e nivelit të adoptimit të rekomandimeve nga opinionet e vlerësimit të korrupsionit mbi Projektligjin për disa ndryshime në Ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”

Projektligji për disa ndryshime në Ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” u depozitua zyrtarisht në Kuvend nga Këshilli i Ministrave më datë 21 korrik 2023. Ky projektligj u publikua gjithashtu në Regjistrin e Konsultimit Publik¹ për komente dhe sugjerime nga qytetarët, gjatë periudhës 04.04.2023 deri më 04.05.2023.

Procesi i konsultimit përfshiu edhe hartimin e Corruption-Proofing of Legislation (CPL) nga ekspertët dhe stafi teknik i Kuvendit, me mbështetjen e projektit të **Westminster Foundation for Democracy** “Forcimi i Llogaridhënies së Qeverisë përmes një Parlamenti më Reagues”, i financuar nga FCDO përmes **Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë**, dhe bazohet në **Metodologjinë Shqiptare për Parandalimin e Korrupsionit**.

Pas këtij procesi, projektligji u miratua nga seanca plenare e Kuvendit më 26 korrik 2024 dhe u botua në **Fletoren Zyrtare nr. 45, datë 12/03/2024, si Ligji Nr. 18/2024, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar²**.

Projektligji iu nënshtrua një procesi vlerësimi në kuadër të të cilit u identifikuan rreziqet dhe faktorët e riskut në dispozitat ligjore, si dhe u hartuan rekomandime konkrete për përmirësimin e përmbajtjes së disa dispozitave dhe për eliminimin ose minimizimin e këtyre rreziqeve. Gjatë këtij procesi, u përgatitën **disa rekomandime për nene të caktuara të projektligjit**.

Nga analiza e tekstit të ligjit të miratuar konkludohet se **kundërshtimet dhe rekomandimet e CPL janë pranuar për një pjesë të neneve**, ndërsa pjesa tjetër e rekomandimeve nuk janë pranuar dhe nuk janë reflektuar në përmbajtjen e neneve përkatëse.

Ligji për lojërat e fatit, i hyrë në fuqi në mars 2024, vijon të mbetet i pazbatueshëm për shkak të mosmiratimit të akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij. Në nenin 33 të ligjit nr. 18/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet miratimi i 12 akteve nënligjore brenda 6 muajve nga miratimi i këtij ligji, konkretisht nga data 15.02.2024.

Aktualisht është miratuar vetëm një vendim i Këshillit të Ministrave, i datës 11.03.2026, “Për përcaktimin e standardeve që kanë të bëjnë me kushtet teknike të sistemit të basteve sportive online, duke përfshirë, por pa u kufizuar në identifikimin dhe regjistrimin e lojtarëve, kërkesat e programeve software dhe hardware, certifikimin e sistemit, procedurat lidhur me faturat dhe

¹ <https://eëë.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/623>

² <https://qzb.gov.al/eli/ligj/2024/02/15/18/03a49b5b-b3cf-412d-9176-05b10b16acaa>

transaksionet e pagesave, parimet e sigurisë dhe kushtet e kontrollit apo të mbikëqyrjes”³. Ky akt ende nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare.

Ndërkohë, 11 akte të tjera nënligjore nuk janë miratuar ende. Këto akte lidhen me:

- Krijimin e një regjistri elektronik të personave që nuk duhet të lejohen të hyjnë në ambientet e lojërave të fatit.
- Kushtet teknike të sistemit të basteve online.
- Procedurën e konkurrimit dhe metodologjinë e pikëzimit të subjekteve nga Komisioni i Licencave.
- Procedurën dhe afatet për revokimin e licencës.
- Kriteret e vlerësimit, afatet, procedurën e konkurrimit dhe metodologjinë e pikëzimit për dhënien e licencës për “Lotarinë Kombëtare”.
- Përdorimin e Fondit të Posaçëm, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Organizimin dhe funksionimin e Këshillit, kushtet dhe kërkesat për financimin e projekteve, si dhe dokumentacionin dhe procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të projekteve nga Këshilli i Mbështetjes së Projekteve.
- Organizimin e punës dhe veprimtarisë së Komisionit të Licencave për vlerësimin e aplikimeve të paraqitura në lidhje me aktivitetin e lojërave të fatit.
- Kushtet fizike dhe teknike për pranimin e basteve.
- Specifikimet teknike të pajisjeve të lotarive.
- Përcaktimin, me udhëzim, të procedurave të konfiskimit, magazinimit dhe shkatërrimit të mjeteve të lojërave të fatit.
- Programet e dedikuara për mbrojtjen e lojtarit.

Mungesa e këtyre akteve nënligjore ka krijuar boshllëqe rregullatore, të cilat kanë pezulluar deri më tani dhënien e 10 licencave kombëtare të parashikuara në ligj⁴, duke e bërë të pamundur funksionimin e mekanizimit ligjor në praktikë.

Në një deklaratë të bërë në njoftimin e akteve të Këshillit të Ministrave të datës 11.03.2026⁵, ministri i Financave bëri me dije se Ministria e Financave është duke punuar për përgatitjen e akteve nënligjore dhe se shumë shpejt do të dalin aktet e tjera. Ndërkohe vonesa ka ardhur pasi kërkohet punë dhe është marrë ekspertizë ndërkombëtare në plotësimin në mënyrë që kuadri ligjor për bastet sportive të jetë sipas standardeve ndërkombëtare.

³ <https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-11-mars-2026/>

⁴ Neni 27/1, pika 1 e ligjit nr. 82/2024

⁵ <https://www.facebook.com/mia.gov.al/>

Në vijim, rekomandimet e CPL janë pranuar për një pjesë të dispozitave të ligjit dhe janë reflektuar në disa prej neneve të tij. Megjithatë, për disa nga këto nene, për të cilat rekomandimet janë marrë në konsideratë, ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e tyre, si vijon:

- **Është pranuar rekomandimi për heqjen e parashikimit në pikën 2 të nenit 52/2**, sipas të cilit anëtarët e Këshillit Mbështetës të Projekteve përfshinin Presidentin e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Presidentin e Federatës Kombëtare të Futbollit, miratuan për shkak të konfliktit institucional të interesit.

Drafti i projektligjit parashikonte:

Zëvendëskryeministri dhe anëtarë janë: ministri përgjegjës për financat, ministri përgjegjës për sportin, ministri përgjegjës për kulturën, ministri përgjegjës për çështjet sociale, ministri përgjegjës për inovacionin, Presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Presidenti i Federatës Kombëtare të Futbollit, titullari i institucionit të teknologjisë së informacionit.

Pas pranimit të rekomandimit, përbërja e Këshillit u ndryshua duke hequr Presidentin e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Presidentin e Federatës Kombëtare të Futbollit nga lista e anëtarëve.

Aktualisht ky organ nuk është në funksion pasi nuk është miratuar ende vendimi i Këshillit të Ministrave në bazë të nenit 52/2, pika 4 për miratimin e aktit nënligjor për organizimin dhe funksionimin e Këshillit, kushtet dhe kërkesat për financimin e projekteve, si dhe dokumentacionin dhe procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të projekteve nga Këshilli i Mbështetjes së Projekteve, si dhe procedurën dhe afatet për revokimin e licencës.

- **Është pranuar rekomandimi** për të adresuar çështjet gjatë konsultimit publik, duke organizuar konsultime shtesë me palët e interesuara dhe shoqërinë civile, veçanërisht për shqetësimet që lidhen me rreziqet korrupsioni, si rreziqet për pastrim parash.
- **Është pranuar rekomandimi** për përfshirjen e dispozitave që garantojnë mbrojtjen e lojtarit, përfshirë ndalimin për personat që marrin ndihmë ekonomike, detyrimin për regjistrimin e identitetit dhe krijimin e një numri falas për këshillim mbi varësinë nga lojërat e fatit. Në funksion të kësaj dispozite ligjore ende nuk janë miratuar aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 5 për krijimin e një regjistri elektronik të personave që nuk duhet të lejohen të hyjnë në ambientet e lojërave të fatit; nenit 7, pika 5 për nxjerrjen e akteve nënligjore të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale për caktimin dhe hartimin e programeve të dedikuara për mbrojtjen e lojtarit.
- **Është pranuar rekomandimi** për parashikimin e një përqindje minimale të pronësisë për aksionarët e huaj (30%) për operatorët e basteve sportive online, duke siguruar transparencë të pronësisë dhe përputhje me detyrimet për deklarimin e pronarëve përfitues.

- **Është pranuar rekomandimi** lidhur me formën e subjekteve/joint ventures dhe për sigurinë që personat me rekorde penale nuk janë pronarët përfitues përfundimtarë.
- **Është pranuar rekomandimi** për qartësimin e të gjitha informacioneve që autoriteti i autorizuar mund të kërkojë nga aplikanti, duke specifikuar kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm. Ligji ka përcaktuar kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm, por ende nuk janë miratuar aketet nënligjore lidhur me procedurën e konkurrimit dhe metodologjinë e pikëzimit të subjekteve aplikuese nga Komisioni i Licencave, dhe kriteret e vlerësimit, afatet, procedurën e konkurrimit dhe metodologjinë e pikëzimit për dhënien e licencës për “Lotarinë Kombëtare”.

Konkluzione

Nga analiza e rekomandimeve të paraqitura në kuadër të procesit të vlerësimit të rrezikut për korrupsion në dispozitat ligjore të caktuara rezulton se kanë synuar forcimin e mekanizmave të integritetit, transparencës dhe kontrollit institucional në sektorin e lojërave të fatit, përmes vendosjes së kriterëve më të qarta për verifikimin e subjekteve aplikuese, kufizimit të diskrecionit administrativ, parandalimit të konfliktit të interesit dhe rritjes së llogaridhënies financiare.

Heqja nga përbërja e Këshillit Mbështetës të Projekteve e Presidentit të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Presidentit të Federatës Kombëtare të Futbollit adreson drejtpërdrejt rrezikun e konfliktit institucional të interesit dhe garanton një strukturë më të pavarur vendimmarrëse. Gjithashtu, respektimi i rekomandimeve për transparencën dhe konsultimin publik, forcimi i mekanizmave të mbrojtjes së lojtarëve, përmirësimi i përbërjes së Komisionit të Licencave me përfaqësim nga Agjencia e Inteligjencës Financiare, si dhe përcaktimi i kriterëve më të qarta për pronësinë, licencimin dhe informacionin e kërkuar nga aplikantët, kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies, transparencës financiare dhe parandalimit të pastrimit të parave.

Megjithatë, pavarësisht reflektimit të disa prej këtyre rekomandimeve në nivel ligjor, mungesa e akteve nënligjore të parashikuara në ligj vijon të përbëjë pengesën kryesore për zbatimin efektiv të tij. Mosmiratimi i shumicës së këtyre akteve kanë pezulluar procesin e licencimit dhe kanë bërë të pamundur funksionimin në praktikë të mekanizmave të parashikuara në ligj.

Në këtë kontekst, miratimi sa më i shpejtë i akteve nënligjore përkatëse përbën një kusht thelbësor për vënien në zbatim të plotë të ligjit, për garantimin e funksionimit të mekanizmave institucionalë të parashikuara dhe për sigurimin e një kuadri rregullator efektiv, transparent dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare në sektorin e lojërave të fatit.